



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 09, datë 26.03.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "IM REZIDENCE" -  
GODINË SHËRBIMI DHE BANIMI 21, 24 KATE ME 6 KATE PARKIMI NËNTOKË,  
ME VENDNDODHJE RRUGËN "KOMUNA E PARISIT", BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "TDT & Partners" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Im Rezidence" - Godinë shërbimi dhe banimi 21, 24 kate me 6 kate parkimi nëntokë, me vendndodhje Rrugën "Komuna e Parisit", Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë "TDT & Partners" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 31/12/2025